

METO  
MUHO

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8.34-1

M 98.




Në ato netët e beharit

81H-1  
1798.

M E T O M U H O

NË ATO NETËT  
E  
BEHARIT



vjersha

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KORRIERI PARTIZAN

Nata ish e zezë, nata ish e eger,  
çan korrieri natën, në xhep ka një letër.

Por ja, përmes drurësh po duken dy **hije**.  
Ziniu nis mendon: «Mos duhet të shtie?»

Iu kujtua shtabi, shokët kur i thanë:  
«Koha më nuk pret, luftrat këto kanë!»

Vrullshëm flakin bombat, nata bëhet **ditë**,  
hiqet Ziniu zvarë, kalon nëpër pritë.

Ç'iu përgjak kraharori, letra ç'iu përgjak,  
ecën nëpër natë, ecën nëpër flakë!

## TE BURIMI

Një dit' vija fushëso  
lodhur ë këputuro.  
Pranë pishës u ndalova,  
në burim syt' i freskova.  
Kur ngrita kryet përpjetë,  
ç'të shoh, vjen thëllëza vetë  
me nja dy shtamba në duar  
më këput me syt e shkruar.  
Me dy-tri fjalë e ngacmova,  
po e pash' që u shpejtova.  
Ajo qeshi e më shikoi,  
mori shtambat edhe shkoi.

1940.

## A T E N T A T O R I

Nëna që të lindi,  
kur të jepte gjinë,  
të futi në gjak  
ndjenjat për lirinë.

U rrite te shkëmbi  
rrahur me furtunë,  
në shi e në breshër,  
me pushkë e me gunë.

Tmerr për tradhtarët  
Tafili me trima,  
në mes të qytetit  
shkrep si vetëtima.

Lule Tafil Gjergji,  
lule Kurveleshi,  
dhe gjermani dridhej,  
kur ti dilje sheshit.

Labja që të lindi  
dhe që të dha gjinë,  
rriti një luan,  
trim për Shqipërinë.

## **KËNGËS KALABREZE!**

Dridhen telat e lahutës,  
dridhet çiftelia,  
këng' e valle në podium,  
lot valle Shqipëria.

Grupet vijnë valë-valë,  
këngët ndjekin vallet,  
në tribunë Kalabria  
këndon e përmallet.

Nëpër këngë e nëpër valle  
ku lahuta dridhet,  
nga gëzimi e lumturia  
Kalabria hidhet!

— Kanë shkuar pesqind vjet  
që kur kam mërguar,  
por jo, këngën shqipëtare  
nuk e kam harruar!

---

1. Grupit të San Benetës të Kalabrisë iu dhurua emblema e Festivalit Folkloristik Kombëtar 1963.



1901 numri 12

## D Y P L A G Ë

Një merak i thellë Havanë e mundon,  
dy plagë në zemër, gjoksi i gufon.  
Për dritën e syve hyn e del n'avlli,  
krisma të shurdhon, vetëtim e shi.  
Luftë më cdo anë, gjaku shkon rrëke,  
bien ndër beteja trimat për atdhe.  
Dhe ja te rrugica dikush vjen ngadalë.  
I shoqi me shokë, s'flasin asnjë fjalë.  
Sa i pa Havaja, në fytyrë u pre.  
— Ku është Mitati, djalin ku ma ke? —  
Jahua i trishtuar i nxori nishanë,  
kapelën me gjak, pushkën e gjerdanë.  
Sa fillon tregimin ç'u bë në Mavrovë,  
mes flakësh mbi tanke luanët u hodhë.  
Fill në mes të fjalës vjen nga Prapanica  
një shok e një shoqe, ca pleq nga Nivica.  
I japin Havasë dhe mandatën tjetër:  
«Aliu si Mitati, yll në mal ka mbetur!»  
Pa po nëna labe tutje malet pa,

mposhti atë dhembje e shokëve u tha:  
«Djemtë unë i linda si i do Shqipëria,  
pa luftë e pa gjak s'fitohet liria.»

31 mars 1944.

## KUR ISHA I VOGËL

Kur isha i vogël,  
u rriç për ibret,  
zbathur cop' e çikë,  
s'vesha nji xhakët.

Në shtëpi përdhese  
me tra shtrema-shtrema,  
çatia me andra,  
ç'bij jasht', binte brenda.

Në sofër nuk pashë  
një gjellë të mirë,  
po në fund të tasit  
dy lugë shëllirë.

Kur shkoja në ara,  
ç'të merrja me vete?

Një copë misërnike  
dhe një gjysmë qepe.

Mëma jasht' e brenda  
në pun' ish e para,  
mbi les' e parmendë  
ngiste qet' në ara.

Kur isha i vogël,  
u rriç për ibret,  
s'kisha kohë për shkollë,  
se kullosja qetë.

## T'IA SHPIE BANDILLIT

Kputa, moj, ç'këputa,  
dy kokrra qershi,  
t'ia shpie bandillit,  
që kam përkarshi.

Kputa, moj, ç'këputa,  
ca shegë thartoshe,  
t'ia shpie bandillit,  
që dergjet në qoshe.

Bleva, moj, ç'bleva,  
dy dardha si gurë,  
t'ia shpie bandillit,  
se është i sëmurë.

Mblodha, moj, ç'mbëlodha,  
disa kokrra thanë,  
t'ia shpie bandillit  
dhe t'i qasem pranë.

## NDJENJË NËNE

Kjo radio Tirana ka dit' që buçet,  
Zeliha Allmeta nënë e vërtetë.  
Në një mëngjes gushti që sapo u zgjuam  
heroizmin tënd të gjith' e dëgjuam.  
Është e madhërishme dashuria jote,  
ndjenj' e bukur nënë, drit' e kësaj toke.

*Gusht 1973.*

## INTENDENTIT

Herët, pa aguar, në dritën e yllit,  
te livadhi i vogël mu në mes të pyllit  
u vendos kazani mu pranë burimit  
për t'u zier qulli. Zjarri flakën shtonte.  
Intendenti i qetë me dru e trazonte.  
Qulli pa yndyrë veç krip' kishte brenda;  
kuzhinë partizane në kushte të rënda.  
S'kishte as gaveta ku të ndahej qulli,  
intendenti e hidhte nëpër pllaka guri.


*Burrel 25 tetor 1944.*

## DËSHMORIT SEJDI MINGA

Pa gdhirë m'u mbush shtëpia,  
bir i nënëso,  
më prun' mandatën për tya,  
bir i nënëso.  
Nënë Minge, bëj durim,  
bir i nënëso,  
ti rrite një djalë trim,  
bir i nënëso,  
Sejdi Mingën si dragua,  
bir i nënëso,  
trim përmbi trimat na u shqua,  
bir i nënëso,  
katër djem të Progonatit,  
bir i nënëso,  
ranë  
në luftë të qershorit,  
bir i nënëso,  
të katër m'u si luanë.



bir i nënëso,  
nëpër flak' rrethimin çanë,  
bir i nënëso.



## **VOGËLUSHE E STANIT**

Pllajës veje, vije,  
vogëlushe e stanit,  
bukë çobanit i shpije,  
borë e bardhë e malit.

S'të pengonte vapa,  
hapin s'e ndaloje,  
s'kishe frik' nga nata,  
mal më mal kaptoje.

Vogëlushe e stanit  
sëç m'i morë mendtë,  
do të vij në nome,  
po ti lidhe qentë

1938.

## KURBETI

O moj zagoriote, çfar jete ke shkuar  
në male të thatë, burrat të mërguar.  
Me një vit martesë mbahej mend rinia,  
tjetra mbetej shpresë, vinte pleqëria.

Ti, moj manushaqe, me brymë behari,  
nga malli ç'u thave porsì fije bari.  
Mbetë, moj e gjorë, me duar në gji,  
djepe nëpër ëndrra, s'tunde një fëmi.

Prite në dritare kushedi sa vjetë,  
dhe burrit i shkrove: «çap e eja vetë»,  
nuk më duhen paret, pa ty jam e shkretë,  
gjithë ven' e vijnë, ti humbe përjetë.»

Perëndoi kurbeti, breng' e kohës parë,  
lotët, zagoriote, tani të janë tharë.  
Në malet e tua çdo gjë ka ndryshuar  
dhe plagët e zemrës të janë shëruar.

## TRËNDAFILE TË BARDHË

Si shqiponjë mali  
drejt kupës së qiellit  
çajne si shigjetë  
vajzat shqipëtare,  
që zbresin nga retë.

S'janë perëndesha  
as zana përralle.  
Janë trimëresha  
vajzat shqipëtare.

Parashutat hapin,  
nëpër qiell zbardhojnë,  
trëndafilë të bardhë  
fushat i mbulojnë.

1972.

## DËSHMORIT RAMIZ MUÇAJ

Erdhën shokët që me natë,  
bir i vetëmo,  
për ty më sollën mandatë,  
bir i vetëmo.

Nënë Lera, bëj durim,  
bir i vetëmo,  
se rrite një djalë trim,  
bir i vetëmo.

Më ike, o dritë e syrit,  
bir i vetëmo,  
pranë buzës së kufirit.  
bir i vetëmo.

Hallall qumështin e gjirit,  
bir i vetëmo!

1944.

## KULLA JONË E LASHTË

Dimrit Kurveleshin  
bora e zbardhon,  
midis katër grykash  
Lera gjelbëron.

Kulla jonë e lashtë  
fole e pëllumbit,  
kurrë s'ka pushuar  
vërshëllim' e plumbit.

Në mes të livadhit  
qëndron si vigan  
kulla jonë e lashtë  
me yll partizan.

## NË SHKËMBINJ TË ÇERMENIKËS

Ato gryka, male atje prap' gjëmuar,  
s'janë krisma pushke që dje na çliruan.  
Godasin vërtet mbi shkëmbinjt' e hirtë,  
po shpërthejnë minat lart në Çermenikë.  
Kaliten vullnetet shkëmbinjve ku zbresin  
dhe buzë humnerës s'kanë frikë se vdesin.  
Në zemër të tyre shpojnë me qysqi,  
furnellat i mbushin për shpërthim të ri.  
Dy arterie zbardhin shkëmbit Çermenikës,  
grykat s'i pengojnë, rrjedhin kaltërsi.  
Kanali i gjatë vrullshëm gurgullon,  
tokat e zhuritura me ujë i freskon.



## O PËRMET I RI

Aeroplan e topa atë ditë s'pushuan,  
nga qielli dhe toka hekur, flakë lëshuan.

Kala partizane s'të shembi tërmeti,  
u tundën dhe malet, po s'u tund Përmeti!

Sot të dridhet zemra, zjarr të djeg në gji,  
tek pret shamiverdhët,<sup>1)</sup> o Përmet i ri.

16 janar 1974

---

1) Ish partizanët e brigadës të V-të Sulmuese.

## DO VETË TË RRI ME TË

Syzezë, më pranë eja,  
ç'më rri sikur shkrep rrufeja?!  
Si unë nuk ka të tjerë,  
vet' je nuse, vet' je vjehrrë.

Ditën që shkele në derë  
ta shtrova me mish e verë,  
me mjalt' e djath' të njomë,  
qeshu si dritë në dhomë.

Er' e luleve të mia,  
ç'ke që të ka rënë zia? .

— More lumë, more përrua,  
s'e kupton që nuk të dua?

Më solli këtu shtëpia,  
s'më prunë këmbët e mia.

Erdha, po zemra më mbeti  
ku dallgët i përplas deti;  
atje tutje n'ato brigje,  
ku thëllëza qan me ligje.

Erdha, po gjumi s'më zë,  
do vete të rri me të.  
Ç'më duhen këto që thua,  
jetën pa zemër ç'e dua?

Viti 1966.

## BILBILI ME GJUHË SHUMË

*Memo Metos*

Dëgjohet zëri i thëllëzës  
herët në agim,  
nëpër rrugë grykës Kuçit  
ia thotë me vajtim.

Bilbili me gjuhë shumë  
ngreu këngëtar,  
për lirinë nuk pushove,  
ndrite si pishtar.

Kënga hapte meloditë  
çdo dit' e çdo natë,  
partizanin në flak' hidhte  
mbi fortifikat.

Si bilbili ligjërove,  
ngrehu, o këngëtar,  
të këndosh për Partinë  
këngë prush e mall.

## SHOVINISTËVE GREKË

*(Sipas tregimit të sime gjysheje)*

Ra një vesë e zbuti dhenë,  
grat' e turqe për ne mbenë  
që të na japin kafënë!

— S'jemi turq, grekë, as bullgarë,  
jemi vetëm shqipëtarë,  
kryq e hënë s'bëjmë be,  
se na s'kemi din e fe.  
Për fe kemi Shqipërinë  
dhe dëshirën për lirinë.  
Iku turku, vjen Juani,  
po këtu ka zot vatani.  
U ngre gjithë Labëria,  
në Konispol u zu vija,  
ta shohin, u plaçin sytë,  
se ku i kemi kufijtë...  
Ta dëgjojë mirë greku,  
barut plumb lëshon dyfeku.  
Shqiptarit me shpat' në dorë  
fitorja i ndrit kurorë.

TRËNDAFILS

U mbush dhoma ma bandillë,  
shok' e shoqe miq të mirë  
për të marrë trëndafil.

— O baba, hiqe mërzinë,  
ngreje gotën, mbyll dollinë,  
se s'pret koha për taksinë.

— Ti m'u trashëgofsh, moj bijë,  
te burri gjeç lumturinë,  
se ne tonat do na vijjnë!

## MALIT DOLI

Thellë zemrës sate  
ishte një dëshirë,  
të çliroje venain,  
të ishe i lirë.

Ndaj një mëngjes lufte  
ti malit u ngjite,  
filladi veç të puthte,  
në çetë të shtynte.

Dhe shokët i gjete  
mbi shkëmbinj e maja,  
tek hidhej përtpjetë  
guri nga murtaja.

Ku malet ushtonin,  
pushka fort seç krisi,

tek rrëzohej trimi  
aty bri një lisi.

Ti pastaj e ngreje  
mbi krahët e tua,  
rrëshqanthi mes plumbash  
zbrisje në përrua.

Aty porsi era  
me ca ujë të kthjellët  
lagje shpejt shaminë  
buzët për t'ia njomur...

Retë përmbi maie  
ndezi vetëtima,  
shokët aty pranë  
hodhën breshërima

Varrin seç ia çelën  
pranë një lugine,  
ti mbi krye i vure  
një degë dafine.

25 korrik 1944.



## LULEKUQES

Atje në bregore  
mbi fijet e barit  
çelin Lulekuqet  
në mes të beharit.

Ç'bukuri që kanë  
arës nëpër grurë,  
tutje nëpër fushë  
tunden si flamurë.

Me to nëpër duar  
fëmijët vrápojnë,  
në tufat e kuqe  
pranverat shikojnë.

*Viti 1952.*

## BORIA PARTIZANE

Ç'ushton boria nëpër maja malesh,  
kuqin zjarre lufte, çajné tinguj vallesh.

Tingujt e borisë zemrat çojné lart,  
kushtrimi i borisë, kënga jonë e zjarrtë.

Ç'po ushton boria përmbi maja malesh,  
kuqin zjarre lufte, ndizen ritme vallesh.

Zëri i borisë ky kushtrim beteje  
shkrepëtim' vetime, bubullim' rrufeje.

## 24 KORRIKUT TË DYZETEDYSË

Një natë korriku  
të qërronte terri,  
si rrufe mbi tela  
kushtrim jep Enveri.

Dridhen telat rrugës  
në fusha, në male,  
në gjithë Shqipërinë  
një furtunë e madhe.

Telat pa shtylla  
dhe pa tela qendrat,  
si koka pa deje,  
si pa vena zemrat.

Lidhja me krahinat  
s'jep asnjë sinjal,

qendra kërcet dhëmbët  
si bisha në mal.

Pushkët, mitralozat  
kryqëzohen në erë,  
ja shtyllat me tela,  
kudo janë prerë.

1942.

## **NË TOKË NUK ZBARKON DOT KËMBË**

Një vapor plot me ushtarë  
nëpër Jon si mal i zi,  
lëshon gjyle me llahtarë,  
u bë hi Lëkurësi.

Ngrihen fshatrat mbrojnë vendin,  
Delvina mbi pellg të zi,  
në tok' s'shkel dot as këmbë,  
se ka zot kjo Shqipëri.

**TË MJERAT NE!**

Grat' e mjera n'Amerik'  
ran' në zi,  
për kë po na zhduken djemtë  
në Azi?  
Fjala «paqe» e Niksonit  
s'bind njeri,  
arkivolë po na sjellin  
në shtëpi.

## HUMELICËS TRIME

O moj Humelicë,  
sipër në bregore,  
me pemë, me vreshta,  
me fushë pjellore.

Ç'bukuri natyre,  
ke, o fshat i vogël,  
aty mbi xhade,  
aty mbi një kodër!

Në shi e në breshër  
kurrë nuk u drodhe,  
si maja e Cepos  
stuhisë i qëndrove.

Rrapojt morën malet  
gjashtë nga një derë,

Vëllezër e motra  
lart ta ngritën nderë.

Të dogji, të poqi  
dy her' italiani,  
të qëlloi me top  
Balli e gjermani.

Ti s'heshte, luftove  
vrullshëm për mbi ta,  
mure e dritare  
i ktheve kala.

Sotir, Vasil, Delo  
dhe të tjerë u vranë,  
para jush, o shokë,  
ne betimin dhamë.

Leonidha Rapi,  
ti je trim i shquar,  
Partia të shkroi emrin  
n'«Yje të pashuar»



Të plagosën, Savo,  
te prita në pyll,  
nga çdo plag e jote  
se ç'u ndez një yll.

Hesht sot lapidari  
aty mbi bregore  
e flet për beteja,  
e flet për fitore...

## KUR VINTE PRANVERA

Kur vinte pranvera, bleronte tërfili,  
mbi kurriz të shtrungës këndonte bilbili,  
Rreth e rrotull stanit rrëzës në Gjoplakë,  
lulet ngjyra-ngjyra tufa manushaqe,  
shikoja limerit në brij e lugina  
delet që kullosin nëpër trendelina.  
Frynte er' e malit me aromë të mirë,  
shkoja pas kopesë therët që pa gdhirë.  
N'ato gropa e sheshe nëpër bar të njomë,  
çaj e lule shqerra lëshonin aromë  
te Buza e Bredhit si zbret në Tisie,  
nga Pusi i Borës ç'uj' i pastër bie.  
Rrija te burimi, delet nëpër hije,  
zogjtë cicëronin këngë dashurije.

---

Pusi i Borës, Tisë, Buza e Bredhit janë emra vendesh.

## HERONJTË E KUOTËS 1309

Agimi mugëtirën e përhap ngadalë,  
mali i Gramozit po fillon të dalë,  
yjet po rrallohen dhe të gjitha zhduken,  
me qindra monarko në luginë duken.

Roja jep sinjalin, plumbi shpon mëngjesin,  
të gjitha frëngjitë me zjarr mbrojnë brezin.  
Si një kosë vigane, kosit mitralozi,  
nga tmerri i vdekjes dridhet dhe Gramozi.

Përsipër avionët flakë djegin tokën.  
Predhat pa pushuar po rrëmihnin tokën.

Zul Gani Demiri qëndron posi shkëmb,  
kufitar Veizit plaga nuk i dhemb.  
Trim Fadil Ferati qëllon drejt në këmbë,  
pranë piramidës nuk lëshon pëllëmbë.

2/8/1949.

## TRAKTET E PARTISË

Ata ishin tre,  
ç'treshe guximtare!  
Në sy të patrullës  
nuk trembeshin fare.

Nata ra e qetë,  
ecin trimat udhës;  
ndihen nëpër natë  
çizmet e patrullës.

Ja, te fundi i shtyllës  
një portret e grisin,  
mbi kokën e Duçes  
shpejt një trakt e ngjisin.

Ngjiten traktet, ngjiten  
në shtylla, në mure,

ato janë thirrje,  
ato janë flamure.

Krismat çojnë natën,  
krismat italiane,  
rrugëve ndihet lehtë  
një këngë partizane.

Ata ngjiten malit,  
malit ngjitet kënga,  
rrugëve ndihen krisma  
dhe çizmet e rënda.

Mizëri fashistët  
që s'u trembën fare,  
ata ishin tre,  
ç'treshe guximtare!

## M A R S H I M

Malet plot me borë s'kishin të mbaruar,  
shokët këmbëzbathur ecnin pa ankuar,  
nga dhembja që ndjenin, harronin urinë,  
harronin dhe lodhjen e pagjumësinë.

Në çdo hap Barjami në shkurre në prag,  
nga stërejti këmbët i pikonin gjak.  
Majës së Valbonës era me furtunë,  
gjurmët përmbi borë nga gjaku u skuqinë.

Musai nuk u step, me këmbë kallkan,  
rrugëve të gjata, shtigje partizane.  
Barjami, Musai, zbathur dit' e natë  
që nga Kurveleshi gjer në Vishegrad...

1945.

## FUNDI I PREFEKTIT

Na ngrihet prefekti,  
çirret si i marrë:  
— Bobo, ç'paská ngjarë!

Rebel Matohiti  
me një grusht kusarë  
Ditën e Flamurit  
na zптоi Guamarë.

Tahir Kolë Gjini  
shpejt po përgatitet,  
me milicat horra  
në Kurvelesh ngjitet.

Lekdushin e djeg,  
flakë çdo shtëpi,

llamburitën malet  
edhe qiell i zi.

Por gjëmojnë grykat,  
dridhet tradhëtari,  
hej, ç'bie në grackë  
ky prefekt zuzari!

Posi minj të trembur  
armiqt' mes rrebeshit,  
i përpin të gjalle  
gryk' e Kurveleshit.



## TRI-KATËR PATATET

Bora pa pushuar binte dit' e nat',  
pishat si minare lart në Vishegrad,  
breshri si plumbi trupin ta dërmonte,  
s'jepej partizani, porsi shkëmb qëndronte.  
Tri-katër patate racionin ne ndanim,  
nga uria e rëndë pa pjekur i hanim.

2 shkurt 1945.

## **DITAT TONA ENDËRRONIM**

Sa herë hënën e shikonim  
që humbiste në hapsirë,  
dritat tona ëndërronim  
bashkë me çdo gjë të mirë.

Terri i netëve na iku,  
dritë në fusha, dritë në male,  
zbardhin llambat elektrike  
posi vjollcat në luadhe.

Rrofsh, parti, sa mali i gjerë  
që na dhe gjith' këto drita,  
çudite botën e tërë,  
ndriçon tërë Republika.

## PËRPARA PORTRITIT

Të gjithë fëmija  
mbenë në portret.  
I ka marrë malli,  
folu, pse s'u flet?

Tregoju për luftën,  
o trimi me fletë,  
si e le kopenë,  
kur vajte në çetë,

Në Lekël gjermanin,  
atë oficerë  
e mbyte me thonj  
si t'ishe skifter.

Folu, Muko Azizi,  
për në Mal të Zi

sa çetnikë shtrive  
me një breshëri?

Të gjithë fëmija  
mbenë në portret,  
tregoju për luftën  
folu, pse s'u flet?

**KËNDREVICËS TRIME**

Këndrevica mal i thatë,  
e regjura në shtrëngatë,  
i ka qëndruar rrebeshit  
me pushkë edhe me shpatë.

Kuçi shumë trima nxori,  
Memo Meto oratori,  
vjersha, këngë nat' e ditë,  
s'do pushojnë meloditë.

Në Mezhgoran hero ngeli  
trim i madh Hasim Zeneli,  
italianët seç i griu,  
doli Vjosa e i përpiu.

Dalipi bir i Nivicës  
ra në rrëzë të Këndrevicës.

Hero Xheladin Beqiri  
nga gjermanë s'iu tremb syri.

Këndrevica, mal i gjerë,  
i përpiu 'armiqt' e tërë!

## JETA E ÇOBANIT

Më pëlqen jeta e malit,  
uji i ftohtë i Spitharit,  
çaj e gjëlberimi i barit.

Më pëlqen jeta e malit,  
çul e ëmbël e çobanit,  
këmborët, zilet e stanit,  
kur zbresin për ujë zallit.

Më pëlqen ajo stanore  
si sorkadhe në bregore,  
pjek bukën, qullin për qenë  
e rreh dybekun nën hënë.

*Viti 1938.*

## H O R M O V E S

Kjo Hormova në përrua  
në klithmë e llahtar u zgjua.

Rënkon toka, dëgjon mali,  
ulërin Drino hallemadhi,

shkel Junani Shqipërinë  
për të marrë Labërinë.

Vijnë me urë në dorë  
ca me thasë, ca me kasorë,

ca me pishë, ca me lak,  
dridhej dhe foshnja në bark!



Therej djali, therej plaku,  
sa u kuq balta nga gjaku.

Hormovit për Shqipërinë  
të gjithë nën thikë u shtrinë!

Ndaj s'pushon nëna me ligje  
si qyqja në shkëmb e brigje.

## PROGONATIT

Progonati në luginë,  
oh, sa bukur gjelbëron,  
makinat ven' e vijnë  
e qytetit i gjason.

Te rrapi sheshi zgjeruar,  
lulishtja me shatërvan,  
kudo rrugët janë shtruar,  
hije pemësh më t'dy anët.

Ujët duke murmuruar  
që prej shkëmbit buron,  
rrjedh në krua i kulluar,  
freskinë gurra ia shton.

Në gurrë u ngrit centrali,  
drita më të katër anë,

materniteti, spitali,  
shkolla, MAPO e dyqan.

Lapidari gjer në retë,  
bukuri që s'perëndon,  
yll' i kuq do ndris' përjetë  
me rrezet që po lëshon.

**PRAPE MBAN PISTOLETËN.**

Atje nën male  
nga kraharor i dheut  
shumë minerale  
ti i dhe atdheut.

Me duart të forta  
prap' mban pistoletën  
e çuditet bota,  
kur lufton për jetën.

Frrok, në dhe të zi.  
kurr' s'je për t'u tretur,  
minierë n'galeri  
zemra të ka mbetur.

## NE ATO NETËT E BEHARIT

Në ato netët e beharit  
që ka fllad e yje shumë,  
çajmë rrugëve të malit,  
gdhijmë arave pa gjumë.

Shamikuqja nëpër gurë,  
shoqen nuk ia bëri nëna,  
çdo pastaf korr e lidh grurë,  
drapri i shkëlqen nga hëna.

Hëna jonë ndrit argjend,  
natën na e kthen në ditë,  
na deh bilbili me këngë,  
era ballin na flladit.

1960.

## PASQYRA E LËNDES

	Faqe
Korrieri partizan .....	3
Te burimi .....	4
Atentatori .....	5
Këngës Kalabreze .....	7
Dy plagë .....	9
Kur isha i vogël .....	11
T'ia shpie bandillit .....	13
Ndjenjë nëne .....	14
Intendentit .....	15
Dëshmorit Sejdi Minga .....	16
Vogëlushe stanit .....	18
Kurbeti .....	19
Trëndafilë të bardhë .....	21
Dëshmorit Ramiz Muçaj .....	22
Kulla jonë e lashtë .....	23
Në shkëmbinj të Çermenikës .....	24
O Përmet i Ri .....	25
Do vete të rri me të .....	26
Bilbili me gjuhë shumë .....	28
Shovinistëve grekë .....	29
Trëndafilës .....	30
Malit doli .....	31
Lulekuqes .....	33
Boria partizane .....	34
24 korrikut të dyzetedytë .....	35
Në tokë nuk zbarkon dot këmbë .....	37

Të mjerat ne! .....	38
Humelicës trime .....	39
Kur vinte pranvera .....	42
Heronjtë e kuotës 1309 .....	43
Traktet e Partisë .....	44
Marshim .....	46
Fundi i prefektit .....	47
Tri-katër patate .....	49
Dritat tona ëndërronim .....	50
Përpara portretit .....	51
Këndrevicës trime .....	53
Jeta e çobanit .....	55
Hormovës. ....	56
Progonatit .....	58
Prapë mban pistoletën .....	60
Në ato netët e beharit .....	61

Tirazhi 2.000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974